



Në bazë të nenit 20 pika 1 alineja 3 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.63/07), neni 3 nga Rregullorja për punë e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Këshilli në mbledhjen e tij e mbajtur në datë 04.02.2015 e miratoi këtë:

**PLAN AKSIONAR VJETOR PËR VITIN 2015
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM TË
RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR**

Plani aksionar për realizimin e Programit të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor bazohet në konceptet bazë të përcaktuara në dokumentet nacionale strategjike, ato rajonale dhe lokale. Gjatë kësaj, angazhimet e institucionit dalin dhe janë të lidhura me realizimin e Programit për zhvillim të rajoni planor Jugperëndimor, të cilën në mars të vitit 2014 e miratoi Këshilli për zhvillim të barabartë rajonal i Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu Programi për zhvillim shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor e mbajtur në datë 02.02.2015. Në këtë dokument bazik për zhvillim të rajonit për periudhën 2015-2019 janë përcaktuar qëllimet afatmesme, prioritetet dhe masat, me çka përmes këtij plani aksionar, përmes projekteve, rritet shkalla e realizimit të vetë Programit të rajonit planor Jugperëndimor

Në këtë dokument janë zhvendosur edhe projektet rajonale të cilat Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor i ka dorëzuar deri te BZHR për vitin 2015. Gjithashtu, pjesë përbërëse e këtij dokumenti janë edhe projektet rajonale që janë pjesë e Listës prioritare me projekte për vitin 2015, nga të cilat dy të përzgjedhura me Vendim të Këshillit për zhvillim të RPJP, Qendra për zhvillim do të dorëzojë deri te GIZ RED dhe Agjencia zvicerane për zhvillim për financim përmes SFS shemës së grandeve.

Nga IPA 3 komponenti në bashkëpunim me MAJPH ka filluar realizimi i dy projekteve të mëdha rajonal nga sfera e infrastrukturës komunale. I pari është Ndërtimi i sistemit për bartjen dhe trajtimin e ujërave të zeza në mikro rajonin e Kërçovës, ndërsa i dyti Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për mbindërtimin e stacionit pastrues në Vranishtë, zgjerimi i sistemit të kolektorit për Liqenin e Ohrit dhe ndarja prioritare e kanalizimit nga ai atmosferik në qytetet e Strugës dhe Ohrit. Pritet në vitin 2015 të vazhdojë përgatitja e dokumentacionit teknik edhe në kuartalin e fundit të shpallen furnizimet publike për ndërtimin e sistemeve.

Për shkak se ky është Plan aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të RPJP, në të janë vendosur edhe projektet të cilat i realizojnë komunat ose subjekte tjera si p.sh OJQ dhe të tjerë që janë në territorin e RPJP dhe për të cilat QZHRPJP ka informacione.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, gjatë vitit 2015 do të përgatisë dhe do të dorëzojë propozim projekte edhe te donatorët ndërkombëtarë, veçanërisht për IPA Bashkëpunimi ndërkufitar (me Shqipërinë dhe Greqinë). Nëse mbarojnë të gjitha procedurat në kohë mund të fillohet edhe me realizimin e tyre në fund të vitit 2015.

Qëllimi afatmesëm 1: Ekonomi rajonale moderne e bazuar në teknologji dhe njohuri të larta						
Prioriteti 1.2 Tërheqja e investitorëve në rajon						
Nr.r.	Masa	Projekti	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Shuma	Partner
1.2.1	Mapimi i potencialeve për investime në rajon	GIS project për menaxhim me tokën ndërtimore nga ana e komunave me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja	1.Vendosja e harduerit dhe softuerit për bazat e të dhënave 2.Krijimi i bazës së të dhënave 3.Trajnime 4.Prezantimi dhe promovimi	8 muaj	2.238.000	QZHRPJP, NJVL, BZHR, MVL
Prioriteti 1.3 Përforcimi i sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në rajon						
1.3.2	Mbështetje të start-up bizneseve	Vizita studimore Promovimi i sipërmarrësve të rinj përmes mbledhjes dhe kultivimit të bimëve	Ngritja e kapaciteteve, publikimi i katalogut, krijimi i klasterit	12 muaj	1.586.800	QZHRPJP, biznes sektori, sipërmarrës të rinj
1.3.3	Shfrytëzimi i programeve për financim të NVM në sektorë	Biznes Qendra për mbështetje dhe shërbime të sektorit privat	1.Përpunimi i strategjisë komunikative dhe Programit për zhvillim të NVM 3.Udhëzues për investime 4.UEB portal 5.Takime me biznes sektorin	8 muaj	1.522.109	QZHRPJP, MPS, të gjithë komunat e rajonit, MVL, UNDP
1.3.4	Lehtësimi i punës në zanatet tradicionale	Ngjallja dhe nxitja e zanateve të vjetra	Rrjetëzimi i zanateve dhe kyçja e tyre për shitje përmes e-shitoreve.	12 muaj	600.000	QZHRPJP, odat e zejtarëve, bartës të e-shitoreve
Prioriteti 1.5 Zhvillimi i infrastrukturës së transportit dhe komunikimit dhe avancimi i hapsirave						
1.5.1	Ndërtimi, rekonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit të trafikut	Projekt bazik dhe ndërtimi i urës (Koroshisht)	1.Изработка на основен проект и ревизија на основен проект 2.Изградба на мост преку Сатецка	12 muaj	7.000.000	QZHRPJP, NJVL, BZHR, MVL
1.5.1	Ndërtimi, rekonstruktimi dhe modernizimi i rrjetit të trafikut	Dokumentacion teknik për rrugë që e lidh Strugën me Qendër Zhupën	Projekt bazik për rrugën Elevci-Dollgash	12 muaj	1.500.000	QZHRPJP, NJVL, Ndërmarrja publike për rrugë

Qëllimi afatmesëm 2: Arsim i përshtatur me nevojat e zhvillimit ekonomik, mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, banorëve të rajonit dhe krijimit të kushteve për parandalim të migracionit						
Prioriteti 2.2 Parandalimi i ikjes së kuadrove profesionale nga veprimtaritë terciare përmes nxitjes së barazisë më të madhe gjinore dhe mundësisë për kyçje në tregun e punës për qytetarët nga grupet e cënuara						
Nr.r.	Masa	Projekti	Aktiviteti	Kohëzgjatja	Shuma	Partnerë
2.2.3	Rritja e ndërgjegjes për barazi gjinore dhe nevoja për përfshirjen e grave në tregun e punës dhe përfaqësuesve tjera nga grupet e cënuara	Trajnime	1.Ngritja e kapaciteteve për PCM dhe ZHR 2.Përgatitja e aplikacioneve për projekte për findet e BE	12 muaj	300.000	QZHRPJP, MVL, GIZ RED AZZHB, UNDP
2.2.3	Rritja e ndërgjegjes për barazi gjinore dhe nevoja për përfshirjen e grave në tregun e punës dhe përfaqësuesve tjera nga grupet e cënuara	Vizita studimore	1.Vizitë agjencive rajonale në BE 2.Shkëmbim përvojash 3.Krijimi i partneriteteve	12 muaj	350.000	KZHRPJP, QZHRPJP, NJVL, MVL, biznes sektori
2.2.3	Rritja e ndërgjegjes për barazi gjinore dhe nevoja për përfshirjen e grave në tregun e punës dhe përfaqësuesve tjera nga grupet e cënuara	Kampanja	Kampanja për ngritjen e vetëdijes për inkluzionin e grupeve të cënuara	8 muaj	300.000	QZHRPJP, NJVL, OJQ, biznes sektori
2.2.3	Rritja e ndërgjegjes për barazi gjinore dhe nevoja për përfshirjen e grave në tregun e punës dhe përfaqësuesve tjera nga grupet e cënuara	Aktivitete promotive	Organizimi i aktiviteteve për promovimin e rasteve të suksesshme	12 muaj	300.000	QZHRPJP, NJVL, OJQ, Biznes sektori, MVL, UNDP

Qëllimi afatmesëm 3: Zhvillim i qëndrueshëm i llojeve selektive të turizmit të ndërlidhura me trashëgiminë kulturore dhe natyrore						
Prioriteti 3.1 Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i konditave të atraksioneve kulturore dhe natyrore në funksion të turizmit						
Nr.r.	Masa	Projekti	Aktiviteti	Kohëzgjatja	Shuma	Partnerë
3.1.1	Përgatitja e dokumentacionit planor urbanistik	Plane urbanistike	1.Plane urbanistike për vendbanimet jo rezidenciale 2.Akte të përgjithshme 3.Plane urbanistike për fshatrat	6 muaj	1.600.000	QZHRPJP, NJVL, BZHR, MVL
3.1.3	Sigurimi i infrastrukturës deri te atraksionet dhe pajisja e tyre	Përgatitja e Projekteve bazike	Projekte bazike dhe revidim për rrugët për këmbësorë dhe biçikleta në rajon (në pajtim me studimin e punuar)	9 muaj	1.300.000	QZHRPJP, NJVL, MVL, GIZ, BE IPA2
3.1.4	Sigurimi i informacioneve, sinjalizimi dhe vizuelizimi i atraksioneve turistike	Info - pika	Përgatitja e planit dhe realizimi i info-pikave, qendrat në rajon	8 muaj	1.300.000	QZHRPJP, NJVL, GIZ, BE IPA2, MVL
3.1.5	Revitalizimi i shtëpive të vjetra dhe ndërtimi i objekteve në zonat rurale për kapacitete akomoduese, objekte afariste dhe shërbyese të ndërlidhura me trashëgiminë etnografike	Dokumentacion teknik për tre etno shtëpi në RPJP (maqedone, shqiptare dhe turke)	Përgatitja e tre Projekteve bazike për tre etno shtëpitë Revidimi i Projekteve bazike	8 muaj	1.300.000	QZHRPJP, NJVL, GIZ, BE IPA2, MVL
Prioriteti 3.3 Krijimi i ofertës turistike rajonale, me qëllim të ndalimit të karakterit sezonal të turizmit dhe shfrytëzim të barabartë të kapaciteteve gjatë gjithë vitit						
3.3.1	Azhurnimi i hartave turistike	UEB Platformë për trashëgiminë kulturore dhe natyrore në RPJP	1.Mbledhja e të dhënave, përgatitja dhe përkthimi 2.Mbushja e bazës së të dhënave 3.Publikimi në UEB	12 muaj	4.000.000	QZHRPJP, NJVL, MVL, Biznes sektori, BE IPA2- Bashkëpunimi ndërkufitar
3.3.7	Promovimi i vlerave turistike me karakter jashtë-sezonal	Aktivitete promovuese në RPJP	Marketingu dhe prezantimi në media Azhurnimi i UEB portalit	12 muaj	300.000	QZHRPJP, 9 komunat nga rajoni

Qëllimi afatmesëm 4: Ruajtja e kualitetit të ambientit jetësor

Prioriteti 4.1 Ndërtimi, rekonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale

Nr.r.	Masa	Projekti	Aktiviteti	Kohëzgjatja	Shuma	Partnerë
4.1.1	Rekonstruktimi i sistemeve të tashme të ujësjellësit dhe ndërtimi i sistemeve të reja të ujësjellësit	Studim për modele të menaxhimit të NNP Proaqua	Përpunimi i dokumentacionit teknik	8 muaj	1.532.500	QZHRPJP dhe komunat e Strugës dhe Ohrit, MAJPH
4.1.2	Vendosja e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturina	Vendosja e kontejnerëve nëntokësor në ambientet urbane në RPJP	Përgatitja e vendeve për vendosjen në lokacionet e përcaktuara Furnizimi me kontejnerë nëntokësor dhe vendosja e tyre	8 muaj	3.393.460	QZHRPJP, NJVL, MVL, BZHR
4.1.2	Vendosja e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturina	Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për vendosjen e sistemit të integruar dhe financiarisht të qëndrueshëm për menaxhim me mbeturinat	Aktivitete përgatitore për përpunimin e Planit Rajonal për menaxhim me mbeturinat	8 muaj		BRMM, QZHRPJP, NJVL, MAJPH, BE IPA2 EuropeAid/136347/IH/SER/MK
4.1.2	Vendosja e sistemit të integruar për menaxhim me mbeturina	Mbledhja dhe trajtimi i mbetjeve nga materialet ndërtimore në RPJP	Përpunimi i dokumentacionit teknik në pajtim me Studimin e punuar për mbetjet nga materialet ndërtimore	12 muaj	1.500.000	BRMM, QZHRPJP, NJVL, MAJPH

Qëllimi afatmesëm 4: Ruajtja e kualitetit të ambientit jetësor						
Prioriteti 4.1 Ndërtimi, rikonstruktimi dhe modernizimi i infrastrukturës komunale						
Nr.r.	Masa	Projekti	Aktiviteti	Kohëzgjatja	Shuma	Partnerë
4.1.3	Sisteme për bartjen e ujërave të zeza komunale dhe stacione pastruese	Ndërtimi i sistemit për bartjen dhe trajtimin e ujërave të zeza në Kërçovë	Punimi i dokumentacionit të nevojshëm për ndërtimin e sistemit Përgatitja e dokumentacionit teknik për ndërtim	12 muaj	18.000.0000	Komuna e Kërçovës, QZHRPJP, MAJPH, IPA3
4.1.3	Sisteme për bartjen e ujërave të zeza komunale dhe stacione pastruese	Kompletimi i sistemit për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit	Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për mbindërtimin e stacionit pastrues në Vranishtë, zgjerimi i sistemit të kolektorit dhe ndarje prioritare të kanalizimit nga ujërat atmosferik në qytetet e Ohrit dhe Strugës	12 muaj	18.000.0000	Komunat e Strugës dhe Ohrit dhe Vevçanit, QZHRPJP, MAJPH, IPA3/OPRD2007-2013/3.1
4.1.3	Sisteme për bartjen e ujërave të zeza komunale dhe stacione pastruese	Ndërtimi i stacionit pastrues në Qendër Zhupë	Përgatitja e aplikacionit për mjete financiare për ndërtim Përgatitja e dokumentacionit teknik për ndërtim	12 muaj	1.800.000	Komuna e Qendër Zhupës, QZHRPJP, MAJPH, Banka Botërore, FM
4.1.3	Sisteme për bartjen e ujërave të zeza komunale dhe stacione pastruese	Ndërtimi i stacionit pastrues dhe kanalizimit në Tërpejcë	Përgatitja e aplikacionit për mjete financiare për ndërtim Përgatitja e dokumentacionit për furnizim publik	12 muaj	1.800.000	Komuna e Ohrit, QZHRPJP, MAJPH, JICA, Banka Botërore, FM
4.1.3	Sisteme për bartjen e ujërave të zeza komunale dhe stacione pastruese	Ndërtimi i kolektorëve nga Gradishte deri në Shën Naum	Përgatitja dhe revidimi i Projektit bazik Përgatitja e aplikacionit për mjete financiare për ndërtim	12 muaj	1.200.000	Komuna e Ohrit, QZHRPJP, MAJPH, JICA, Banka Botërore, FM

Qëllimi afatmesëm 4: Ruajtja e kualitetit të ambientit jetësor						
Prioriteti 4.2 Avancimi i mbrojtjes së biodiversitetit, ajrit, ujit dhe tokës						
Nr.r.	Masa	Projekti	Aktiviteti	Kohëzgjatja	Shuma	Partnerë
4.2.1	Mbrojtja e biodiversitetit	Studim fizibiliteti për vlerësimin e gjendjes së	Përpunimi i dokumentacionit teknik të nevojshëm	8 muaj	1.075.000	QZHRPJP dhe komunat e Strugës,

		lumenjve të cilët derdhen në Liqenin e Ohrit				Debërcës dhe Ohrit, MAJPH
4.2.2	Kualitetit i ajrit	Realizimi i objekteve efikase energjetike dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë në RPJP	Përgatitja e furnizimit publik dhe shpallja Përzgjedhja e organeve mbikëqyrëse Ndërrimi i dritareve dhe izolimi i tavanit në SHF “Vëllezërit Milladinovci” - Strugë Ndërrimi i dritareve në SHF “Mirko Mileski” - Kërçovë Instalimi i sistemit me kolektorë solar në OP “Breshia” - Dibër	8 muaj	5.095.720	Komunat e Strugës, Kërçovës dhe Dibrës, QZHRPJP, MVL, BZHR
4.2.2	Kualitetit i ajrit	Studim për shfrytëzimin e potencialeve gjeotermale në mikro rajonin e Dibrës	Punimi i studimit Prezantimi i studimit para të gjithë palëve të interesuara	8 muaj	1.200.000	QZHRPJP, NJVL, ME
4.2.2	Kualitetit i ajrit	Stacion për qentë endacak në RPJP	Punimi i studimit Prezantimi i studimit Kampanjë Plan aksionar	8 muaj	1.200.000	QZHRPJP, NJVL, NPK, OJQ